



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“RIPARIM I PAJISJEVE ELEKTRONIKE”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

E6-IV-20

Tiranë, 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Riparim i pajisjeve elektronike”			Kodi E6-IV-20
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional profili “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë teknik të mesëm për kryerjen implementimit, mirëmbajtjes dhe operimin e sistemeve të telekomunikacionit, për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme të “Elektroteknikë”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, ; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Supplementin përkatës të teknikut të mesëm në këtë fushë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje që ofrojnë të shërbimeve të pajisjeve elektronike ose operojnë me pajisje dhe sisteme elektronike, në njësitë e shitjes së pajisjeve elektronike, në njësi të ndërlidhjes në institucione, në institucione të ndryshme shtetërore (laboratorë shkencore, institucione të tjerat etj., si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e riparimeve të pajisjeve elektronike.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektronike” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	<i>(kur të miratohet)</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparëshme	K-II-02-14			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Menaxhim dhe organizim

- Të interpretojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sektorit të elektroteknikës në vend;
- Të përshkruajë rëndësinë e mbikëqyrjes së punëve të përditshme;
- Të përshkruajë rëndësinë e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të përshkruajë rëndësinë e trajnimit të stafit të nivelit të ulët;
- Të interpretojë llojet e dokumentacionit shoqërues dhe përdorimin i tyre;
- Të përshkruajë proceset e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit të BNJ
- Të përshkruajë mënyrat e paraqitjes së ofertave financiare;
- Të identifikojë llojet e faturave financiare;
- Të interpretojë të dhënat financiare;
- Të interpretojë monitorimin e faturave, procedurave të trajtimit të parave dhe proceseve bankare;
- Të përshkruajë mënyrat bazë për të kontrolluar kostot e shërbimeve të riparimit të pajisjeve elektronike;
- Të argumentojë mënyrën e krijimit dhe administrimit të buxheteve.
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit ergonomik të vendit të punës.

Legjislacioni dhe standardet

- Të përshkruajë legjislacionin në fushën e elektroteknologjisë në vend;
- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar të punës, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të shpjegojë legjislacionin në fuqi të tatim taksave;
- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë për fushën e elektroteknikës;
- Të shpjegojë ç`janë standardet IEC (International Electrotechnical Commission) në Elektroteknikë;
- Të përshkruajë standardet e hartuara nga Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik dhe pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS);
- Të përshkruajë standardet ISO dhe OHSAS në fushën e elektroteknologjisë mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë, mbi sistemet e menaxhimit të mjedisit, sigurisë së informacionit, etj.;
- Të identifikojë kontratat standard të punës, të shërbimit, të shit-blerjes;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut;
- Të shpjegojë masat që duhen marrë për dhënien e ndihmës së parë;
- Të shpjegojë rëndësinë e masave të marra për parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së raporteve me shkrim për gjetjet e evidentuara;
- Të interpretojë të dhënat për të evidentuar tendencat dhe problematikat në vendin e punës;
- Të listojë objektivat bazë të sigurimit teknik për pajisjet dhe instalimet elektrike/electronike;

- Të shpjegojë rëndësinë e instruktimit të rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtës së mjedisit;
- Të vlerësojë mjedisin e punës, mjetet dhe pajisjet duke u siguruar për ndjekjen e praktikave të mira dhe standardeve të sigurisë bazuar mbi legjislacionin në fuqi;
- Të klasifikojë llojet e dokumentacionit për sigurimin teknik dhe mënyrat e ruajtjes;
- Të përshkruajë rregullat dhe procedurat e standardit OHSAS 18001 që lidhen me veprimtaritë dhe proceset që kryhen për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë standardet IEC për mbrojtjen nga rryma elektrike, mbrojtjen nga shoku elektrik, mbrojtjen nga efektet termike, mbirryma;
- Të argumentojë rregulloret e brendshme e kompanisë;
- Të përshkruajë procedurat e evakuimit, përdorimin e kutisë së MZSH, llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë rregullat e trajtimit, klasifikimit, dhe grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme si bateri, kondensatorë dhe elementë të tjerë elektronikë në përputhje me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë;
- Të përshkruajë raporte të incidenteve dhe aksidenteve me qëllim identifikimin e shkaqeve dhe parandalimin në kohë të tyre;
- Të përshkruajë problematika mjedisore dhe masat korrigjuese;
- Të identifikojë programet për mbrojtjen e mjedisit sipas proceseve dhe standardit ISO 14001;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

Dokumentacioni teknik

- Të listojë llojet e dokumentacionit teknik;
- Të shpjegojë rëndësinë e raportimeve, format dhe mënyrat e tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të shërbimeve të instalimit dhe konfigurimit, format dhe mënyrat e tij;
- Të përshkruajë mënyrat e gjenerimit të raporteve dhe të prezantimeve;
- Të identifikojë mënyrat e organizimit të dokumentacionit sipas llojit të përdorimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e manualeve të përdorimit, instalimit apo shërbimit të pajisjeve elektronike;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të problemeve dhe mënyrën e korrigjimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të shërbimeve të mirëmbajtjes;
- Të shpjegojë rëndësinë e grafikut të mirëmbajtjes dhe mënyrën e hartimit të tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e kushteve të garancisë së pajisjeve elektronike;
- Të listojë elementët e domosdoshëm të formatit të certifikatës së garancisë;
- Të listojë dokumente shoqëruese të pajisjes elektronike për sigurinë dhe cilësinë.
- Të përshkruajë mënyrën e mbajtjes së ditarit (log) për funksionimin e pajisjes;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të një liste kontrolli për shërbimet gjatë punimeve në pajisjet elektronike;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të aktit të dorëzimit të pajisjes dhe elementët përkatës të tij;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të një preventivi teknik pas diagnostikimit të pajisjeve elektronike;

TIK në elektronike

- Të përshkruajë elementet dhe mënyrën e operimit të rrjetave të komunikimit;
- Të shpjegojë modulet dhe funksionimin e kompjuterëve personal, pajisjet periferike I/O;

- Të përshkruajë sistemet e operimit;
- Të shpjegojë mënyrat e komunikimit fizik dhe pa kabull;
- Të përshkruajë teknologjinë Ethernet dhe të tregojë shembuj të konfigurimit të internetit;
- Të përshkruajnë standardet në fushën e sigurisë së të dhënave;
- Të përshkruajë bazat e algoritmikës;
- Të shpjegojë bazat e programimit dhe gjuhët kryesore të programimit;
- Të identifikojë operatorët aritmetikë dhe të krahasimit dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e shfrytëzimit të qarqeve të programueshme;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të MULTISIM apo simulatoreve të tjerë të ngjashëm;

Elektronika

- Të shpjegojë problemet kryesore që lidhen me ndërtimin e qarqeve të integruara;
- Të listojë përdorime të aplikimit të qarqeve të integruara;
- Të shpjegojë skema të ndryshme sipas llojit të amplifikatorit;
- Të përshkruajë dallimin ndërmjet kodeve themelore (BCD) dhe kodeve speciale (ASCII);
- Të shpjegojë mënyrën e formimit të kodeve dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë veçoritë kryesore të qarqeve logjike (gjendjet logjike, faktori i degëzimit, marxhina e zhurmës, koha e vonimit);
- Të përshkruajë parimin e funksionimit të multiplekserit dhe demultiplekserit;
- Të krahasojë parimin e punës së flip-flopeve SR, JK,T dhe D;
- Të interpretojë skemat me flip-flop;
- Të shpjegojë njësinë aritmetike-logjike (ALU);
- Të shpjegojë punën e shndërruesve D/A dhe A/D;
- Të interpretojë skemat e shndërruesve D/A dhe A/D;
- Të shpjegojë funksionin e shndërruesve AC/DC dhe DC/AC;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe përdorimin e sensorëve të llojeve të ndryshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e optoelektronikës dhe parimet përkatëse;
- Të analizojë skema të ndryshme komandimi të ventilave të rregullueshëm gjysmëpërçues (përdorimi i elementeve shumë shtresore);
- Të analizojë skema të ndryshme të rregullatorëve të tensionit (konvertitorët dhe invertitorët);
- Të tregojë parimin e punës së skemave të ndryshme të drejtuesve industrialë të rrymës;
- Të tregojë parimin e punës së skemave të ndryshme të rregullimit elektronik të shpejtësisë së motorëve;
- Të shpjegojë mënyrat e instalimit të sistemit të operimit në pajisjet elektronike;
- Të përshkruajë mënyrat e konfigurimit të pajisjeve elektronike;

Matjet dhe instrumentet matës

- Të dallojë llojet e mjeteve dhe pajisjeve matëse të punë, përdorimet dhe rolin e tyre;
- Të japë konkluzione të dokumentuara për matjet, eksperimentet dhe propozimet për përmirësim ose ndryshim;
- Të shpjegojë metodat e duhura për matjet elektrike analoge dhe digitale me instrumenta përkatës;
- Të përshkruajë karakteristikat operationale të gjeneratorëve të sinjalit, gjeneruesit e fuqisë skanera etj.;
- Të përzgjedhë instrumenta për matjen e presionit, temperaturës, rrjedhjes, niveli, vibrimi etj.;
- Të dallojë fuqitë dhe faktorët e fuqisë, induktivitetin, rezonancën magnetike;

- Të interpretojë terminologjinë dhe simbolikat e përdorimit të instrumenteve matës;
- Të dallojë elementët elektronik që mund të testohen në qark dhe ata që duhet të shkëputen prej tij;
- Të klasifikojë metodat e kalibrimit dhe dokumentimet e nevojshme sipas procesit përkatës;

Diagnostikimi i pajisjeve elektronike

- Të përshkruajë radhën e punës në procesin e diagnostikimit dhe rëndësinë e zbatimit të saj;
- Të përshkruajë rëndësinë e përcaktimit të saktë të defektit, si dhe shkakun për të shmangur përsëritjen e tij;
- Të listojë llojet e matjeve për diagnostikimin e defekteve në pajisjet elektronike;
- Të listojë llojet e defekteve kryesore në pajisjet elektronike dhe mënyrat e përcaktimit të tyre;
- Të riprodhojë eksperimente me pajisje specifike testimi për analizë të detajuar në gjetjen e problematikave ose përmirësimin e performancës së pajisjeve;
- Të listojë llojet e sinjalistikave dhe kodet e problemit (error code);
- Të përshkruajë rëndësinë e teknikave të kontrollit të lidhjeve elektrike në pajisjet elektronike gjatë procesit të diagnostikimit;
- Të përshkruajë teknika të kontrollit të vendosjeve apo fiksimeve mekanike të pajisjeve elektronike për diagnostikimin e defekteve;
- Të përshkruajë rëndësinë e teknikave të kontrollit të sistemit të operimit në pajisjet elektronike;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të portave të komunikimit të pajisjeve elektronike me rrjetin e komunikimit;
- Të përshkruajë teknika të kontrollit të faktorëve të jashtëm me ndikim në pajisjet elektronike si presioni, temperatura, lagështia etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e teknikave të kontrollit të parametrave të nevojshëm për mirëfunksionimin e pajisjeve, si furnizimi me elektricitet, ujë, gaz etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit vizual dhe akustik për diagnostikimin e defekteve në pajisjet elektronike;
- Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të informacionit të marrë nga klientët pas testimit paraprak;
- Të klasifikojë pjesët përbërëse të pajisjes diagnostikuese sipas funksionit/procesit që kryen secila pjesë.
- Të analizojë nëse një defekt është i lidhur me historikun (log) të pajisjes elektronike;

Shërbimet në pajisjet elektronike

- Të përshkruajë pajisjet elektronike analoge, llojet, ndërtimi, funksionimi dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë pajisjet elektronike dixhitale, llojet, ndërtimi, funksionimi dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë procese e punës të pajisjeve elektronike në gjuhën teknike;
- Të përshkruajë defektet kryesore të pajisjeve elektronike;
- Të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të grafikut të mirëmbajtjes, sipas afateve kohore dhe kushteve të përdorimit të pajisjeve elektronike;
- Të listojë llojet e mirëmbajtjeve të pajisjeve elektronike;
- Të listojë mjetet dhe veglat e punës që përdoren për mirëmbajtje duke përshkruar përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë teknika të mirëmbajtjes në pajisjet elektronike;
- Të shpjegojë shërbimet e riparimit, hapat dhe metodat e punës;

- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të rrugëve përcjellëse dhe pikave të kontaktit në qark;
- Të përshkruajë mënyrat e lidhjes së qarqeve apo elementeve sic janë fishat, filmat, fije përçuese, kablllo etj.;
- Të listojë rastet e zëvendësimit të elementëve në pajisjet elektronike;
- Të përshkruajë rëndësinë e përshtatjes së pjesës së zëvendësuar me funksionalitetin e pajisjes;
- Të argumentojë nevojën për riparime ose zëvendësime të pjesëve në pajisjet elektronike;
- Të përshkruajë mjetet dhe materialet e saldimit;
- Të përshkruajë mënyrat e saldimit për riparimin e pajisjeve elektronike dhe rastet e përdorimit të tij;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe rastet e përdorimit në riparimet e pajisjeve elektronike;
- Të listojë mjetet dhe materialet që përdoren për pastrimin e kontakteve në pajisjet elektronike
- Të shpjegojë rëndësinë e kalibrimit në pajisjet elektronike;
- Të shpjegojë procesin e lubrifikimit dhe përdorimin e tij;
- Të listojë llojet e materialet dhe mjetet për lubrifikim;
- Të shpjegojë procesin e montim/çmontimit të pjesëve përbërëse të pajisjes elektronike;
- Të përshkruajë procesin e zëvendësimit të elementëve elektronik të qarkut;

Sipërmarrje dhe edukim për karrierën

- Të identifikojë cilësi të personave të suksesshëm në sipërmarrje;
- Të identifikojë rëndësinë e arsimit dhe trajnimit në zhvillimin e një sipërmarrje;
- Të vlerësojë përdorimin e informacionit dhe të teknologjive të komunikimit në një sipërmarrje biznesi;
- Të analizojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrësve në shoqëri;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të një plan veprimi për të përmirësuar aftësitë sipërmarrëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e rolit udhëheqës në grup në një veprimtari konkrete;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të karrierës duke analizuar detyra dhe raste të suksesshme nga jeta e të rriturve, bota e punës dhe sipërmarrja;
- Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit në mënyrë kritike, në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake, mundësitë e tij/saj për karrierën duke marrë parasysh konsumin dhe buxhetin personal, shëndetin dhe përgjegjësitë sociale, si dhe prirjet e tregut të punës;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Menaxhimi dhe organizimi

- Të zbatojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sektorit të elektroteknikës në vend;
- Të realizojë mbikëqyrjen e punëve të përditshme;
- Të realizojë trajnimin e stafit të nivelit të ulët;
- Të përdorë dokumentacion shoqërues;
- Të zbatojë proceset e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit të BNJ
- Të përpilojë ofertat financiare;
- Të përpilojë faturat financiare;
- Të realizojë monitorimin e faturave, procedurave të trajtimit të parave dhe proceseve bankare;

- Të planifikojë kostot e shërbimeve të riparimit të pajisjeve elektronike;
- Të zbatojë elemente të sipërmarrjes në projekte konkrete;
- Të hartojë një plan biznesi për shërbime të riparimeve të pajisjeve elektronike;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi të tatim taksave;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar për fushën e elektroteknikës të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të zbatojë standardet IEC (International Electrotechnical Commission) në Elektroteknikë;
- Të zbatojë standardet e hartuara nga Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik dhe pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS);
- Të zbatojë standardet ISO dhe OHSAS në fushën e elektro-teknologjisë mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë, mbi sistemet e menaxhimit të mjedisit, sigurisë së informacionit, etj.;
- Të respektojë kontratat standard të punës, të shërbimit, të shit-blerjes;
- Të përdorë në mënyrë korrekte terminologjinë e fushës edhe në gjuhë të huaj.

TIK në elektronikë

- Të instalojë sistemin operativ në kompjuter;
- Të konfigurujë sistemin operativ në kompjuter;
- Të diagnostikojë problemet e sistemit të operimit në kompjuter;
- Të zgjidhë një problem në algoritmik;
- Të konvertojë algoritmin në një gjuhë programimi të nivelit të lartë;
- Të ekzekutojë kode në një gjuhë programimi të nivelit të lartë;
- Të ndërtojë skemën e një rrjeti komunikimit;
- Të projektojë skema me anë të programeve simuluese (MULTISIM);
- Të programojë qarqe të programueshme për projekte të ndryshme;
- Të realizojë skemën e lidhjes së kompjuterit në rrjet;
- Të caktojë adresat IP të pajisjeve të lidhura në rrjet;
- Të konfigurujë rrjetin IP.

Diagnostikimi dhe matjet

- Të kryejë kalibrimin e sistemit të instrumenteve sekondar duke përdorur instrumentet primar, si dhe dokumentimin mbi vlefshmërinë e testeve dhe kontrolleve;
- Të përzgjedhë teknika të shpejta dhe të besueshme për vlerësimin e stresit fizik tek komponentët elektronike;
- Të japë konkluzione mbi testimet e kryera në bateri dhe akumulatorë në lidhje me cilësinë e tyre;
- Të përzgjedhë metodologjitë e duhura për ekzaminimin e skemave dhe qarqeve të integruar;
- Të hartojë instruksione operative për aparatet e matjes dhe kontrollit sipas proceseve të kërkuara;
- Të dokumentojë metodologjinë e ndjekur në diagnostikim dhe aparate matëse;
- Të vlerësojë produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e një pajisjeje elektronike nëpërmjet matjeve dhe testeve duke i krahasuar me parametrat e duhur teknikë;
- Të zbatojë radhën e punës në procesin e diagnostikimit;
- Të përcaktojë saktë defektin dhe shkakun e tij;

- Të kryejë kontrollin vizual dhe akustik për diagnostikimin e defekteve në pajisjet elektronike;
- Të vlerësojë informacionin e marrë nga klientët pas testimit paraprak;
- Të kryejë matjet të ndryshme për diagnostikimin e defekteve në pajisjet elektronike;
- Të kryejë eksperimente me pajisje specifike testimi për analizë të detajuar në gjetjen e problematikave ose përmirësimin e performancës së pajisjeve;
- Të dallojë llojet e sinjalistikave dhe kodet e problemit (error code);
- Të zbatojë teknika të kontrollit të lidhjeve elektrike në pajisjet elektronike gjatë procesit të diagnostikimit;
- Të zbatojë teknika të kontrollit të vendosjeve apo fiksimeve mekanike të pajisjeve elektronike për diagnostikimin e defekteve;
- Të zbatojë teknika të kontrollit të sistemit të operimit në pajisjet elektronike;
- Të kryejë kontroll të portave të komunikimit të pajisjeve elektronike me rrjetin e komunikimit;
- Të zbatojë teknika të kontrollit të faktorëve të jashtëm me ndikim në pajisjet elektronike si presioni, temperatura, lagështia etj.;
- Të zbatojë/përdorë teknika të kontrollit të parametrave të nevojshëm për mirëfunksionimin e pajisjeve, si furnizimi me elektricitet, ujë, gaz etj.;
- Të dallojë pjesët përbërëse të pajisjes diagnostikuese sipas funksionit/procesit që kryen secila pjesë;
- Të përcaktojë nëse një defekt është i lidhur me historikun (log) të pajisjes elektronike;

Shërbime të pajisjeve elektronike

- Të instalojë dhe konfigurojë pajisjet elektronike analoge në varësi të llojit, ndërtimit dhe funksionimit të tyre;
- Të instalojë dhe konfigurojë pajisjet elektronike dixhitale në varësi të llojit, ndërtimit dhe funksionimit të tyre;
- Të lexojë skemën dhe manualin e shërbimeve për riparimin e pajisjeve elektronike;
- Të përzgjedhë pajisjet, mjetet dhe materialet e punës për riparimin;
- Të përdorë veglat dhe pajisjet izoluese gjatë punës për riparimin e pajisjeve elektronike;
- Të zëvendësojë elementët me defekt (ure greatz, kondestator, rezistence, siguresë, tranzistor, diode, etj.);
- Të riparojë linjat përcjellëse në qark dhe pikat e kontaktit;
- Të zëvendësojë në rast defekti fishat lidhëse, fijet përçuese, kabllot etj.;
- Të montojë qarqet elektronike sipas skemave të caktuara;
- Të çmontojë dhe të montojë qarqet e integruara, duke vlerësuar më parë gjendjen e tyre;
- Të zëvendësojë modulën (bllok ushqimi, bllok kontrolli, etj.) me defekt;
- Të përshtatë pjesën e zëvendësuar me funksionalitetin e pajisjes;
- Të çmontojë elementin e dëmtuar;
- Të saldojë elementin e ri në vendin e elementit të dëmtuar;
- Të pastrojë dhe të përforcojë kontaktet e elementeve elektronike sipas nevojës;
- Të vlerësojë llojin e shërbimit për riparime ose zëvendësime të pjesëve në pajisjet elektronike;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve elektronike;
- Të respektojë grafikun e mirëmbajtjes, sipas afateve kohore dhe kushteve të përdorimit të pajisjeve elektronike;
- Të përdorë mjetet dhe veglat e punës për mirëmbajtje të pajisjeve elektronike;
- Të zbatojë teknika të mirëmbajtjes në pajisjet elektronike;
- Të testojë pajisjen për mirëmbajtje parandaluese sipas grafikut të mirëmbajtjes;

- Të pastrojë ventilatorët;
- Të kontrollojë parametrat termik të pajisjes;
- Të lubrifikojë dhe grasatojë elementët sipas grafikut me mjetet dhe materialet
- Të kalibrojë pajisjen elektronike;
- Të kryejë shërbime pastrimi sipas nevojës me mjetet dhe materialet e duhura;
- Të zëvendësojë elementët në fund të ciklit të jetës;
- Të kryejë teste të sigurisë elektrike;

Dokumentacion

- Të përzgjedhë llojin e dokumentacionit teknik sipas qëllimeve dhe përdorimeve;
- Të kryejë raportime sipas formave dhe mënyrave të paracaktuara;
- Të kryejë dokumentimin e shërbimeve të instalimit dhe konfigurimit sipas formave dhe mënyrave të paracaktuara;
- Të gjenerojë raporte dhe të prezantime sipas formatit dhe kërkesës;
- Të përdorë manuale të përdorimit, instalimit apo shërbimit të pajisjeve elektronike
- Të kryejë dokumentimin e problemeve dhe mënyrën e korigjimit të tyre.
- Të kryejë dokumentimin e shërbimeve të mirëmbajtjes;
- Të hartojë dhe përditësojë grafikun e mirëmbajtjes;
- Të plotësojë dokumentin për kushtet e garancisë apo certifikatës së garancisë së pajisjeve elektronike, sipas formatin të paracaktuar;
- Të zbatojë mënyrën e duhur të mbajtjes së ditarit (log) për funksionimin e pajisjes;
- Të hartojë një listë kontrolli për shërbimet gjatë punimeve në pajisjet elektronike;
- Të hartojë një akt të dorëzimit të pajisjes sipas procedurave të paracaktuara;
- Të hartojë një preventiv teknik pas diagnostikimit të pajisjeve elektronike;
- Të përpilojë një urdhër të thjeshtë pune;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të mirëmbajë dokumentacionin e detyrueshëm ligjor në zbatim të legjislacionit Shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të vlerësojë listat e menaxhimit të riskut me qëllim evidentimin dhe uljen e rreziqeve;
- Të zbatojë procedurat e emergjencës dhe të evakuimit;
- Të hartojë procedura operacionale të sigurisë dhe ambientale që identifikon rreziqet në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për kryerjes së punimeve elektroteknike;
- Të japë ndihmën e parë;
- Të zbatojë kushtet e punës në mënyrë të sigurt për të mbrojtur veten dhe të tjerët, duke shmangur sjellje që mund të sjellin rreziqe;
- Të demonstrojë shembullin e mirë në përdorimin e mjeteve personale mbrojtëse (PPE), shenjave të rrezikut dhe instruksioneve të pajisjeve;
- Të raportojë defektet dhe rreziqet potenciale që vërehen gjatë punës, me qëllim eliminimin në kohë të tyre;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të grumbullojë llojet e materialeve që përdoren në elektro-teknike për parandalimin e ndotjes së ambientit në vendin e punës;
- Të mbështesë aktivisht objektivat dhe strategjitë e kompanisë për mbrojtjen e mjedisit;

- Të zbatojë rregullat dhe procedurat e standarteve ISO 14001 dhe OHSAS 18001 që lidhen me veprimtaritë dhe proceset që kryhen për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë standardet IEC për mbrojtjen nga rryma elektrike, mbrojtjen nga shoku elektrik, mbrojtjen nga efektet termike, mbirrymat;

Sipërmarrje dhe edukim për karrierën

- Të përdorë teknologjive e informacionit dhe të komunikimit në një sipërmarrje biznesi;
- Të hartojë një plan veprimi për të përmirësuar aftësitë sipërmarrëse;
- Të ndër marrë rol udhëheqës në grup në një veprimtari konkrete;
- Të përdorë dhe menaxhojë njohuritë, shprehitë e marra në lëndë të ndryshme në lidhje me hulumtimin, planifikimin dhe vendimmarrjen për karrierën;
- Të përdorë familjen, biznesin dhe sipërmarrjet nga komuniteti, si burime për të hulumtuar ndikimin e tyre në karakterin personal dhe etikën me qëllim planifikimin e karrierës;
- Të hulumtojë dhe planifikojë karrierën duke analizuar detyra dhe raste të suksesshme nga jeta e të rriturve, bota e punës dhe sipërmarrja;
- Të vlerësojë në mënyrë kritike, në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake, mundësitë e tij/saj për karrierën duke marrë parasysh konsumin dhe buxhetin personal, shëndetin dhe përgjegjësitë sociale, si dhe prirjet e tregut të punës;
- Të planifikojë hapat për karrierën bazuar në vendimmarrje;
- Të zbatojë elemente të sipërmarrjes në projekte konkrete.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

